


**RAPORTI** i punëtorisë së vizionimit  
“Vizioni për lagjen Jeta e Re”

Shtator 2016



## **PËRMBAJTJA**

1. Hyrje

2. Lokacioni dhe problematika e shqyrtuar

3. Aktivitetet e vizionimit

3.1. Takimi i parë me grupin e komunitetit

3.1.1. Propozimet e dala nga komuniteti

3.2. Takimi i dytë me grupin e komunitetit

3.3. Projekti përfundimtar i vizionimit të lagjes

3.3.1. Rruga interne e lagjes dhe komponentët përcjellëse të saj

3.3.2. Objekti multifunksional - Qendra e komunitetit, lokalet afariste dhe terreni i sportit

3.3.3. Parku me lojëra të fëmijëve

3.3.4. Tregu i mbuluar

3.3.5. Parku / shtegu i vrapimit

Përpiluan:

Betim Vitija, BA ark

Genc Gafurri, M ark

## 1. Hyrje

Punëtorja e vizionimit "Vizioni për lagjen Jeta e Re" është zhvilluar në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës", i cili tenton t'i artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit.

Qasja "nga poshtë-lartë" që synon përfshirjen e komunitetit apo grupeve tjera relevante, mundëson injektimin e një dimensionit human në procesin e planifikimit urban, i cili tradicionalisht është trajtuar si një proces i pastër teknik. Me vendosjen e banorit në qendër të vëmendjes të planifikimit, sigurohet zgjidhje e qëndrueshme për hapësirën e trajtuar dhe njëkohësisht forcon ndjenjën e përkatësisë të komunitetit në hapësirat që i shfrytëzon.

Ky raport përmban përshkrimin e të gjitha fazave të punës të cilat kanë dërguar deri te përpilimi i projektit përfundimtar, të paraqitura në vazhdim.

### 1 Takimi i parë me grupin e komunitetit

Identifikimi i nevojave të banorëve dhe propozimi i zgjidhjeve të mundshme.

### 2 Draft projektit

Vizuelizimi i propozimeve të zgjidhjeve të diskutuara në takimin e parë.

### 3 Takimi i dytë me grupin e komunitetit

Prezantimi i draft projektit dhe diskutimi rreth propozimeve shtesë apo modifikimeve të projektit.

### 4 Projekti përfundimtar

Përpilimi i projektit dhe raportit përfundimtar që përmban informatat nga gjitha fazat paraprake.

## 2. Lokacioni dhe problematika e shqyrtuar

Lagja "Jeta e Re" është një zonë kryesisht e re në periferi të qytetit e cila shtrihet në pjesën veriperëndimore të tij, përgjatë rrugës në drejtim të Gjakovës. Paralelisht me rrugë kalojnë edhe binarët e trenit që aktualisht janë jashtë funksionit.

Pjesa e lagjes që kontakton me rrugën kryesore ka kryesisht përmbajtje afariste (pompa, objekte hotelerike, depo të materialeve, tregje joformale të drurit për djegie etj.), ndërsa ana tjetër e saj karakterizohet kryesisht me objekte individuale banimi, në disa raste të kombinuara me përmbajtje afariste si dhe me objekte sociale (shkolla dhe qendra e mjekësisë familjare). Paralelisht me rrugën kryesore dhe binarët e trenit shtrihet edhe rruga interne e lagjes që aktualisht është e paasfaltuar.




Fig.1. Pozita e zonës të trajtuar





**Fig.2.** Dukjet e lokacionit

Në Mars të vitit 2016 është organizuar takimi i përfaqësuesve të organizatës EC Ma Ndryshe me banorët e lagjes për të diskutuar rreth problemeve me të cilat përballen ata dhe bazuar në të gjeturat nga ky takim, punëtoria e vizionimit si fazë e ardhshme e këtij procesi është fokusuar në trajtimin e:

- rrugës interne të lagjes dhe komponentëve përcjellëse të saj, dhe
- hapësirave publike dhe infrastrukturës sociale.

### **3. Aktivitetet e vizionimit**

#### **3.1. Takimi i parë me grupin e komunitetit**

Takimi i parë me grupin e komunitetit është zhvilluar me qëllim të identifikimit të nevojave të banorëve dhe propozimin e zgjidhjeve për to. Përveç ekspertëve dhe përfaqësuesve të EC-it, në takim kishte edhe 24 pjesëmarrës të cilët janë banorë të lagjes dhe i përkasin kryesisht komunitetit RAE. Për arritjen e rezultateve të pritura, duke marrë parasysh natyrën e problematikave të shqyrtuara, punëtoria është zhvilluar në 4 faza: pjesa hyrëse, identifikimi i problemeve, njoftimi i pjesëmarrësve me planin rregullues dhe propozimi i zgjidhjeve nga ana e pjesëmarrësve.

**Pjesa hyrëse** kishte për qëllim lehtësimin e leximit të hartave për pjesëmarrësit. Gjatë këtij procesi pjesëmarrësit të ndarë në 2 grupe kanë tentuar të përcaktojnë lokacionin e disa objekteve karakteristike (reperëve) të lagjes, duke ngjitur fotografitë e tyre në pozitat adekuate në ortofoto.

**Identifikimi i problemeve** është bërë përmes diskutimeve për mangësitë aktuale të zonës, me fokus të veçantë në rrugën interne afër binarëve e cila shtrihet paralelisht me rrugën kryesore, infrastrukturës në përgjithësi, hapësirave publike dhe problemeve sociale të zonës. Pozita e problemeve fizike të identifikuara janë paraqitur në harta.

**Prezantimi i planit rregullues të zonës** është bërë pas pauzës dhe ka shërbyer si parapërgatitje për fazën e propozimit të zgjidhjeve duke pasur si referencë planet e qeverisjes lokale për këtë zonë. Në këtë fazë pjesëmarrësit janë njoftuar me destinimin e hapësirave, koeficientet e ndërtimit, propozimin për devijim të hekurudhës dhe karakteristika tjera të ngjashme të parapara në këtë plan.

**Propozimi i zgjidhjeve** është zhvilluar në dy grupe dhe propozimet dhe idetë e reja për zhvillimin e lagjes janë paraqitur përmes vizatimeve dhe në formë verbale. Grupi i parë ka pasur si temë analizën e hapësirave publike dhe blloqet e banimit kolektiv të zonës, ndërsa që grupi i dytë ka trajtuar rrugën interne afër binarëve të trenit dhe hapësirave publike përreth. Punëtorja është përmbyllur me prezantimet e shkurtra të propozimeve të realizuara nga grupet tematike.



**Fig.3.** Pamje nga takimet e organizuara me komunitetin

### 3.1.1. Propozimet e dala nga komuniteti

Problemet me të cilat ballafaqohen banorët e lagjes të identifikuar gjatë takimit kanë të bëjnë me infrastrukturën, paqartësinë rreth pronësisë të disa parcelave të zonës, hapësirat publike dhe parametrat e ndërtimit të parapara në planin rregullues. Më detajisht, problemet e identifikuar dhe zgjidhjet e propozuara nga komuniteti janë të paraqitura në tabelën vijuese.

PROBLEMET E IDENTIFIKUARA	ZGJIDHJET E PROPOZUARA
Kushti për sipërfaqe minimale të parcelës prej 3 ari për dhënie e lejes së ndërtimit nga autoritetet komunale.	Adresimi i kërkesës nga banorët për ndryshimin e këtij kushti në rastin e revidimit të planit rregullues.
Kapaciteti i pamjaftueshëm (shtypja e ulët) i furnizimit me ujë të pijes.	Ridërgimi i kërkesës në Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit për zëvendësimin e gypit furnizues Ø160mm me gyp të ri Ø300mm.
Reduktimet e shpeshta dhe uji i papastër i pijes.	
Pozicioni i papërshtatshëm i trafostacionit në pjesë të frekuentuar afër rrugës interne. Disa muaj më parë ka qenë shkaktar i djegies të një shtëpie afër saj.	Rilokimi i trafostacionit.
Rreziku nga shtyllat elektrike të cilat janë të pasigurta sidomos në rastet e motit me erë.	Zëvendësimi i rrjetit ekzistues me sistem nëntokësor të distribuimit të rrymës.
Ndotja e ajrit nga pluhuri që vjen nga rruga (interne) e pashtuar.	Largimi i binarëve ekzistues dhe krijimi i një rruge të profilit me 2 korsi, trotuare në të dy anët e saj, parking dhe shtigje për biciklistë.
Qasja e rrugës interne në rrugën kryesore realizohet vetëm në pikat terminale të saj, në distancë rreth 900m në mes tyre.	Krijimi i 2 ose 3 kyçjeve të reja në rrugën kryesore në distanca përafërsisht të barabarta.
Mungesa e terreneve sportive dhe lojërave për fëmijë.	Kërkesa në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër për fletët poseduese të parcelave përgjatë rrugës, për shqyrtimin e mundësisë së ndërtimit të hapësirave publike në parcelat me pronësi shoqërore, apo blerja e parcelave private për këtë qëllim.
Mungesa e parkut dhe hapësirave të gjelbra.	
Qendra e komunitetit "Iniciativa 6" është e vendosur në objekt privat të marrë më qira.	

Gjatë prezantimit të planit rregullues u evidentua që pjesëmarrësit nuk kishin informacione në lidhje me përmbajtjen e planit në fjalë. Përderisa devijimi i hekurudhës në drejtim të zonës industriale konsiderohet si pozitiv, vërejtja kryesore e komunitetit ishte te koeficientët e ndërtimit (indeksi i sipërfaqes së përgjithshme  $ISP=2.0$ ), sipas të cilëve del se në lagje është paraparë të

ndërtohen objekte për banim kolektiv prej 3-5 kate që nuk përkon me vizionin e banorëve për zhvillimin e ardhshëm të lagjes së tyre. Pjesëmarrësit pa përjashtim preferojnë që zona ta ruajë destinimin aktual të banimit individual.

### 3.2. Takimi i dytë me grupin e komunitetit

Objektivi kryesor i këtij takimi ishte prezantimi i projektit të bërë nga ana e ekspertëve, vlerësimi i pjesëmarrësve për përmbushjen e kërkesave që kanë qenë të determinuara gjatë takimit të parë, si dhe propozimi i zgjidhjeve shtesë për plotësimin e projektit deri në versionin përfundimtar të tij. Në këtë punëtori ishin prezent gjithsej 13 pjesëmarrës nga komuniteti, pjesa më e madhe e të cilëve ishin prezent edhe në takimin e parë. Prezantimi është realizuar përmes vizatimeve të printuara (kopje të forta) dhe përmes projektorit, me qëllim të përshkrimit më të detajuar të secilës prej hapësirave të trajtuara. Në fazën e diskutimit të propozimeve doli që pjesëmarrësit nuk kishin vërejtje për zgjidhjet e prezantuara, por u diskutua mundësia e ndërtimit të një kopshti fëmijësh në parcelën shoqërore me nr. 5647-1. Parcela në fjalë e cila ka sipërfaqe prej 8.24 ari mundëson ndërtimin e një çerdhe me kapacitet të vogël dhe në fazat e mëtejshme duhet të analizohet nëse çerdhja ekzistuese në lagjen Ortakoll i plotëson nevojat e rrethinës apo duhet të ndërtohen institucionet e reja të kësaj natyre.

### 3.3. Projekti përfundimtar i vizionimit të lagjes

Propozimet e paraqitura në projekt janë të bazuara në fletët poseduese të lëshuara nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Prizrenit pas kërkesës së bërë nga komuniteti me datën 18.07.2016. Me ndihmën e këtij informacioni janë përcaktuar hapësirat që janë në pronësi shoqërore, të cilat mund të akomodojnë funksionet e reja të kërkuara nga banorët.




Fig.4. Dispozita e parcelave me pronësi shoqërore

Zhvillimi i qëndrueshëm është një nga fjalët kyçe në intervenimet urbanistike bashkëkohore, prandaj përveç aspektit funksional dhe estetik, kujdes i veçantë i është kushtuar edhe racionalitetit të zgjidhjeve të cilat do të lehtësojnë mirëmbajtjen dhe menaxhimin e lehtë të tyre.



### 3.3.1. Rruga interne e lagjes dhe komponentët përcjellëse të saj

Rruga interne me gjatësi totale  $l=842\text{m}$  planifikohet të fitojë dukje dhe funksion të një rruge me standarde, që përveç komunikacionit motorik do të sigurojë edhe mobilitetin e këmbësorëve dhe biciklistëve. Detajet e rrugës janë të trajtuara në mënyrë të tillë që e bëjnë atë lehtë të qasshme për personat me aftësi të kufizuara bazuar në Udhëzimin Administrativ nr. 33/2007.

Përveç kyçjes ekzistuese të rrugës interne në rrugën tranzite, është paraparë që ajo t'i ketë edhe 3 kyçje tjera në rrugën kryesore. Kyçja ekzistuese në drejtimin veriperëndimor do të zhvendoset te rrethrotullimi i ri në mënyrë që t'iu mundësojë vozitësve zgjedhje më të lehtë të drejtimin të lëvizjes në rrugën kryesore. Rrugët kyçëse kanë gjerësinë  $b=6.0\text{m}$  me 2 kors për lëvizje në 2 drejtime.




Fig. 5. Skema e kyçjeve të rrugës interne

Sipas kërkesave të përcaktuara gjatë punëtorisë, profili i rrugës interne do të përmbajë:

- 2 kors të asfaltuara për komunikacion motorik me gjerësi  $b=5.5\text{m}$ ,
- 49 vendparkingje të vendosura paralelisht me rrugën (0□),
- 2 trotuare për lëvizjen e këmbësorëve me gjerësi mesatare  $b=2.0\text{m}$ , dhe
- shtegun për biciklistë me gjerësi  $b=2.0\text{m}$ , dhe
- hapësirat e gjelbërimit të cilat fitohen me heqjen e binarëve, gjerësia e të cilave është variabile dhe varet nga gjendja në terren.

Përveç karakteristikave të përshkruara, rruga do të pajiset me ndriçim publik, orendi urbane (ulëse dhe shporta të mbeturinave) dhe pjesët tjera të infrastrukturës siç janë: rrjeti i ujësjellësit, rrjeti i ujërave fekalë, rrjeti i ujërave atmosferikë, rrjeti i shërbimeve tjera të rrymës së dobët (telefonja, TV kabllorik, interneti etj.), me theks të veçantë në krijimin e rrjetit nëntokësor të distribuimit të energjisë elektrike si një nga nevojat urgjente të lagjes.

ndërtesa

trotuari

parkingu

rruga

gjelbërimi

shtegu i  
biciklistëve

trotuari

gjelbërimi

ndërtesa

210


210

550

90


200

230




3.3.1. Profili i rrugës interne





pozita e zonës



### 3.3.2. Objekti multifunksional - Qendra e komunitetit, lokalet afariste dhe terreni i sportit

Objekti multifunksional planifikohet të vendoset në parcelat nr. 5655-1 dhe 5654-1 me sipërfaqe totale prej 24.36ari. Përdhesa do të përmbajë hapësirat e qendrës së komunitetit dhe lokalet afariste në pronësi të Komunës me sipërfaqe 830m<sup>2</sup>, ndërsa në kat (kulmin e rrafshët) do të vendoset fusha e sportit. Qasja deri te fusha e sportit do të bëhet nga ana juglindore e objektit me ngritje graduale të terrenit me pjerrtësi  $i=6\%$  në mënyrë që të jetë e qasshme për personat me aftësi të kufizuara. Përveç shtigjeve të këmbësorëve, pjesa tjetër e terrenit do të jetë sipërfaqe e gjelbëruar në formë të një amfiteatri natyral në dispozicion për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore të komunitetit. Në kuadër të objektit janë paraparë edhe tualetet publike të ndara sipas gjinisë. Lokalet afariste përveç që do të jenë një aset shtesë i komunës, ato do të mundësojnë gjenerimin e mjeteve për mirëmbajtjen e qendrës të komunitetit që siguron jetëgjatësi dhe menaxhim efikas të qendrës.



Objekti multifunksional - Qendra e komunitetit, lokalet afariste dhe terreni i sportit  
3D dukja






Objekti multifunksional - Qendra e komunitetit, lokalet afariste dhe terreni i sportit  
3D dukja






pozita e zonës



### 3.3.3. Parku me lojëra të fëmijëve

Parcela nr. 5649-1 me sipërfaqe 15.40ari është destinuar për parkun me shëtitore në kuadër të të cilit do të jenë edhe lojërat për fëmijë me sipërfaqe prej 2.70ari. Parku karakterizohet me gjelbërim të lartë intensiv, shtigjet për ecje, ulëset dhe orenditë tjera minore urbane. Për shkakë sigurie dhe kufizimin e lëvizjes vetëm brenda hapësirës të dedikuar, pjesa e lojërave të fëmijëve është e rrethuar me gardh dhe mur të gjallë, ndërsa qasja bëhet vetëm nga ana e parkut. Gjatë stinëve të ngrohta është paraparë të vendoset një strukturë e përkohshme me funksion të snack-bar që njëkohësisht do të sigurojë mirëmbajtjen e parkut.



Parku me lojëra të fëmijëve

3D dukja







Parku me lojëra të fëmijëve

3D dukja





pozita e zonës



### 3.3.4. Tregu i mbuluar

Tregu i mbuluar është paraparë të vendoset në parcelën nr. 592-2. Tregu ka sipërfaqen prej 550m<sup>2</sup>, ndërsa pjesa tjetër do të përmbajë parkingun për 16 automjete me mundësi zgjerimi dhe në vazhdim deri te rrethrotullimi do të zë vend sipërfaqja e gjelbëruar me shtigje të këmbësorëve, ulëseve dhe orendive tjera urbane. Duke vërejtur mungesën e një tregu adekuat në këtë pjesë të qytetit, kjo hapësirë mund të fitojë karakterin e një tregu në shërbim të disa lagjeve, ku madhësia e nevojshme dhe rrezja e shërbimit mund të përcaktohet në fazat e mëvonshme përmes një studimi më të gjerë të distribuimit të shërbimeve publike në kuadër të qytetit.





Tregu i mbuluar  
3D dukja






Tregu i mbuluar  
3D dukja





pozita e zonës



### 3.3.5. Parku / shtegu i vrapimit

Hapësira që përfshin parcelat nr. 6979-1, 6969-2 dhe 6968-2 e cila karakterizohet me gjerësi të vogël dhe gjatësi rreth 260m', është paraparë të shndërrohet në park me gjelbërim të lartë intenziv, shtigje të këmbësorëve, ulëse dhe orendi urbane të nevojshme. Gjelbërimi i planifikuar do të sigurojë komoditet më të lartë të pjesës jugperëndimore të lagjes, duke e mbrojtur atë nga zhurma dhe papastërtitë që vijnë nga rruga kryesore e cila ka frekuencë të lartë të komunikacionit motorik. Në park mund të integrohet edhe shtegu i vrapimit me gjatësi deri në 500m' që do të japë një alternativë shtesë për rekreim banorëve të lagjes apo edhe banorëve të zonës përreth.



Parku / shtegu i vrapimit

3D dukja